



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 1247/4 Prot.

Tiranë, më 2/11/2013

U R D H E R
Nr. 22, datë 02/11/2013

Mbështetur në ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr 211, datë 11.09.2008 "Për zgjedhjen e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" dhe nr 225, datë 13.11.2008 "Për miratimin e strukturës organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Hetim-Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit Universiteti "Justiniani I" Tiranë.

KONSTATOVA

Në zbatim të urdhrit nr.209 datë 08/10/2013 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale u ushtrua kontrolli administrativ pranë kontrolluesit Universiteti "Justiniani I" me adresë bulevardi "Zogu i Parë", Tiranë me objekt:

- Masat lidhur me sigurinë e të dhënave personale (neni 27).

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale pasi shqyrtoi procesverbalin e kontrollit administrativ, si dhe provat e administruara vëren se:

I. Kontrolluesi Universiteti "Justiniani I" Tiranë nuk ka në fuqi një rregullore të veçantë për mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale vlerëson se hartimi i rregulloreve është një pjesë e rëndësishme e masave të sigurisë që në tërësi zbaton kontrolluesi, prandaj është shumë e rëndësishme që ju si kontrollues të hartoni rregullore të veçantë për të përcaktuar rregulla për mbledhjen, përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave personale. Në rregullore duhet të përcaktohen nivelet e përdoruesve (*administrator, punonjës sekretarie, staf akademik, student*), të drejtat e tyre, aksesit etj, si dhe rregulla lidhur me konfidencialitetin e të dhënave personale. Përmirësimi dhe plotësimi i rregullave është një siguri më shumë për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të subjekteve të të dhënave gjatë përpunimit të të dhënave personale që kryeni ju si kontrollues.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale mungesën e marrjes së këtyre masave e konsideron shkelje të nenit 27 pika 1 të ligjit nr. 9887 datë 10.3.2008 "Për Mbrojtjen e të

Dhënave Personale” i ndryshuar ... “Kontrolluesi ose përpunuesi merr masa organizative dhe teknike të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, aksidentale, humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, veçanërisht kur përpunimi i të dhënave bëhet në rrjet, si dhe nga çdo formë tjetër e paligjshme përpunimi”.

2. Kontrolluesi Universiteti “*Justiniani I*” mbledh dhe përpunon të dhëna personale nëpërmjet përdorimit të sistemit të “*video survejimit*” (CCTV), në ambientet e tij ku përfshihen, sallat e leksioneve, korridoret e brendshme. Qëllimi i përdorimit të sistemit të “*video survejimit*” (CCTV) i cili kryen përpunim e imazheve të cilat janë të dhëna personale me karakter të veçantë fizik nuk është deklaruar nga kontrolluesi në asnjë dokument të tij.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale vlerëson se sistemi i “*video survejimit*” (CCTV) duhet të përdoret duke mos ndërhyrë në privatësinë e studentëve dhe punonjësve të cilëve u përpunohet e dhëna personale (imazh). Përdorimi i sistemit të “*video survejimit*” (CCTV) duhet të bëhet në atë formë që përpunimi i të dhënave të kryhet në përputhje me të drejtat themelore të njeriut, të drejtën për privatësi, të mbrojtura nga neni 8 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut i miratuar me ligjin nr.8137, datë 31.07.1996.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale vlerëson se kontrolluesi mund të përdor sistemin e “*video survejimit*” (CCTV) duke vendosur kamera vetëm në hyrjet e daljet e sallave të leksioneve duke mos mbajtur nën vëzhgim studentët dhe punonjësit gjatë gjithë kohës së mbajtjes së leksioneve. Ju duhet të përdorni mjete dhe metoda të tjera me të cilat të kontrolloni mënyrën e mbajtjes së leksioneve nga ana e punonjësve (lektorëve), si dhe mënyrën e sjelljes së studenteve në këto leksione, pa pasur nevojë të ndërhyhet në privatësinë e studentëve dhe lektorëve përmes përdorimit të sistemit të “*video survejimit*” (CCTV) gjatë gjithë kohës së zhvillimit të leksioneve.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale vlerëson se në korridoret e brendshme mund të përdoret sistemi i “*video survejimit*” (CCTV) për qëllime të ruajtjes së sigurisë dhe disiplinës në ambientet e kontrolluesit. Qëllimi i përdorimit të këtij sistemi në këto ambiente duhet të shprehet shumë qartë në rregulloren që duhet të përgatitni ju si kontrollues lidhur me sistemin e “*video survejimit*” (CCTV), si dhe koha e ruajtjes së imazheve dhe shkatërrimi i tyre.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale konsideron, mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave personale të studentëve dhe punonjësve nëpërmjet përdorimit të sistemit të “*video survejimit*” (CCTV) në sallat e leksioneve, të tepërt, jo proporcionale dhe në shkelje të:

- ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*” i ndryshuar nenin 5 pika 1 germa “c”... “*Mbrojtja e të dhënave personale bazohet ; në mjaftueshmërinë e të dhënave,të cilat duhet të lidhen me qëllimin e përpunimit dhe të mos e tejkalojnë këtë qëllim*”
- Udhëzimit nr.3 datë 05.03.2010 i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale “*Mbi sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera*” i ndryshuar, pika 4 germa a “*Sistemi i video survejimit nuk duhet të ndërhyje në jetën private të individëve. Përpunimi i të dhënave me anë të sistemit të video survejimit mund të lejohet vetëm nëse qëllimi për të cilin është instaluar ky sistem nuk mund të arrihet në një mënyrë tjetër*”

- Udhëzimit nr. 3 datë 05.03.2010 i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale *“Mbi sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera”* i ndryshuar, pika 4 germa f ...*“instalimi dhe përdorimi i sistemit të video survejimit duhet të bëhet në atë formë që përpunimi i të dhënave të kryhet në përputhje me të drejtat themelore të njeriut, të drejtën për privatësi dhe të drejtën për jetë private dhe familjare. Këto të drejta janë të mbrojtura nga neni 8 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut i miratuar me ligjin nr.8137, datë 31.07.1996, si dhe ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale”*

3. Kontrolluesi Universiteti *“Justiniani I”* nuk ka vendosur tabela për informimin e shpejtë dhe të qartë të subjekteve të të dhënave personale për përdorimin e sistemit të *“video survejimit” (CCTV)* duke shkelur nenin 18 të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”* i ndryshuar, si dhe pikën 4/dh të Udhëzimit nr.3 datë 05.03.2010 *“Mbi sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera”* i ndryshuar, të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale .

4. Kontrolluesi Universiteti *“Justiniani I”* nuk ka hartuar rregullore për mënyrën përdorimit të sistemit të *“Kamerave Vëzhgim-Regjistrimi” (CCTV)* në ambientet e tij duke shkelur: nenin 27/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”* i ndryshuar...*“Kontrolluesi ose përpunuesi merr masa organizative dhe teknike të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, aksidentale, humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, veçanërisht kur përpunimi i të dhënave bëhet në rrjet, si dhe nga çdo formë tjetër e paligjshme përpunimi”*.

Sa më sipër:

Në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”* i ndryshuar, si dhe nenet 107-109 të K. Pr. Administrative ;

U R D H E R O J

1. Në zbatim të nenit 5 pika 1/c të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”* i ndryshuar dhe Udhëzimit nr.3 datë 05.03.2010 i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale *“Mbi sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera”* i ndryshuar:
 - Të ndalohet menjëherë mbledhja dhe përpunimi i të dhënave personale përmes përdorimit të sistemit të *“video survejimit” (CCTV)* në sallat e leksioneve.
 - Të shkatërrohen menjëherë të dhënat personale (*imazhe*) të mbledhura dhe të përpunuara përmes përdorimit të sistemit të *“video survejimit” (CCTV)* në sallat e leksioneve.
2. Në zbatim të nenit 18 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”* i ndryshuar dhe Udhëzimit nr.3 datë 05.03.2010 i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale *“Mbi sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera”* i ndryshuar:

- Të vendosen menjëherë tabela informimi në vende të dukshme për informim të subjekteve të të dhënave personale për përdorimin e sistemit të "video survejimit" (CCTV). Tabelën tip mund ta gjeni në faqen zyrtare www.kmdp.al.
3. Në zbatim të nenit 27/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar si dhe Udhëzimit nr.3 datë 05.03.2010 i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale "Mbi sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera", i ndryshuar:
 - Të hartohet rregullore e veçantë lidhur me mënyrën e mbledhjes, përpunimit dhe ruajtjes së të dhënave personale. Rregulloren tip mund ta gjeni në faqen zyrtare www.kmdp.al, si dhe ofrojmë asistencën tonë.
 - Të hartohet rregullore për qëllimin, mënyrat e mbledhjes, kohës së ruajtjes dhe përpunimit, të të dhënave personale nëpërmjet përdorimit të sistemit të "video survejimit" (CCTV), ju ofrojmë asistencën tonë.
 4. Kryerja e këtyre detyrimeve të rëndësishme të realizohet brenda një afati kohor prej 45 (dyzet e pesë) ditësh, nga momenti i marrjes dijeni të këtij Urdheri.
 5. Për plotësimin e këtyre detyrimeve të njoftohet me shkrim pranë Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
 6. Me kalimin e këtij afati në rast mospërbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, sipas të cilit... "Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të rekomandimeve të tij, vepron sipas nenit 39 të këtij ligji dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave".
 7. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë

KOMISIONERI

FLORA ÇABEJ (POGAÇE)

